

VENDIM
Nr. 663, datë 23.10.2024

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE OPERATIVE, PËR VITIN 2025, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2025, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) në shumën 71 449 000 (shtatëdhjetë e një milionë e katërqind e dyzet e nëntë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)
Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2025

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2025 (lekë)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	49,776,700
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	7,899,260
3	Shërbime e furniturë	13,773,040
	TOTALI	71,449,000